



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

RREGULLORE (P) NR. 03/2016
PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË AUTORIZIMEVE NGA
PRESIDENTI PËR LIDHJEN E MARRËVESHJEVE
NDËRKOMBËTARE SI DHE PËR PROCEDURËN E
RATIFIKIMIT TË MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE
NGA PRESIDENTI

Prishtinë, 07.10.2016



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

Presidenti i Republikës së Kosovës,
në mbështetje të nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6, nenit 14 (7) dhe nenit 17 (2.7) të Ligjit Nr. 03/L-094, për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 47, 25 janar 2009), duke marrë parasysh kompetencat e Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimeve për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në Ligjin nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 16 dhjetor 2011), si dhe duke marrë parasysh propozimin e Sekretarit të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, miraton:

RREGULLORE (P) NR. 03/2016
PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË AUTORIZIMEVE NGA PRESIDENTI PËR
LIDHJEN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE SI DHE PËR PROCEDURËN E
RATIFIKIMIT TË MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE NGA PRESIDENTI

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave për:
 - 1.1. dhënien e autorizimit nga Presidenti për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare;
 - 1.2. dhënien e autorizimit nga Presidenti për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare, të cilat hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit. si dhe
 - 1.3. ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nga Presidenti.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet nga Departamenti për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Zyrës së Presidentit, për të gjitha kërkesat drejtuar Presidentit për dhënien e autorizimeve për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare si dhe për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1. **President** nënkupton Presidentin e Republikës së Kosovës;
- 1.2. **Kuvend** nënkupton Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- 1.3. **Autorizim** nënkupton dokumentin që lëshohet nga Presidenti përmes të cilit emëron një ose disa persona që përfaqësojnë atë në zhvillimin e bisedimeve ose nënshkrimin e marrëveshjes ndërkombëtare;
- 1.4. **Ratifikim** nënkupton aktin me të cilin Presidenti në emër të Republikës së Kosovës, në nivelin ndërkombëtar, jep pëlqimin e vet të lidhë marrëveshje ndërkombëtare, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- 1.5. **Ligji për marrëveshjet ndërkombëtare** nënkupton Ligjin nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 16 dhjetor 2011);
- 1.6. **Agjenci shtetërore ose agjenci shtetërore përkatëse** nënkupton institucion fusha e kompetencave e të cilit mbulon fushëveprimin e marrëveshjes;
- 1.7. **Departamenti për Çështje Juridike (DÇJ)** nënkupton Departamentin për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Zyrës së Presidentit.
- 1.8. **Zyrtar përkatës ligjor** nënkupton të punësuarin/en në Departamentin për Çështje Juridike.

KAPITULLI II - DHËNIA E AUTORIZIMIT NGA PRESIDENTI PËR KRYERJEN E VEPRIMEVE TË NDËRLIDHURA PËR LIDHJEN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

Neni 4

Kompetenca për dhënien e autorizimit për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare

Kompetenca për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, që kanë të bëjnë me: territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake; të drejtat dhe liritë themelore; anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare; marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës, autorizohet nga Presidenti pas rekomandimit nga Qeveria.

Neni 5

Vendimi nga Qeveria për të rekomanduar dhënien e autorizimit nga Presidenti

Rekomandimi drejtuar Presidentit të Republikës së Kosovës, për dhënien e autorizimit për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, të përcaktuar në Nenin 4 të kësaj rregulloreje, bëhet pasi të nxirret Vendimi nga Qeveria për të rekomanduar dhënien e autorizimit nga Presidenti.

Neni 6

Kërkesa për dhënien e autorizimit nga Presidenti

1. Kërkesës për dhënien e autorizimit nga Presidenti, e cila dorëzohet nga Qeveria, duhet t'i bashkëngjiten, në letër dhe në formë elektronike, dokumentet si në vijim:
 - 1.1. Vendimi nga Qeveria për kërkesën e dhënies së autorizimit nga Presidenti;
 - 1.2. Letrën shpjeguese për marrëveshjen ndërkombëtare, që përfshin por nuk kufizohet në opinionet e dorëzuara nga ministritë ose agjencitë shtetërore gjatë periudhës së shqyrtimit;
 - 1.3. Tekstin e marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe dhe, sipas nevojës, në gjuhën e huaj përkatëse.

Neni 7

Shqyrtimi i kërkesave

1. Rekomandimi nga Qeveria, drejtuar Presidentit, për dhënien e autorizimit për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare, shqyrtohet nga Departamenti për Çështje Juridike, gjegjësisht zyrtari përkatës ligjor i caktuar nga drejtori i departamentit.
2. Nëse rekomandimi nuk është në pajtim me legjislacionin përkatës apo nuk është e kompletuar sipas legjislacionin përkatës në fuqi, Departamenti për Çështje Juridike e kthen rekomandimin tek propozuesi dhe kërkon plotësimin e kërkesës apo përmirësimin e tij dhe për këtë e njofton Kabinetin e Presidentit.
3. Nëse rekomandimi është në pajtim me legjislacionin në fuqi, Departamenti për Çështje Juridike përgatit propozim autorizimin sipas Shtojcës një (1) (Autorizim për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare) të Rregullores dhe së bashku me Opinion Ligjor e dërgon për nënshkrim tek Presidenti.

Neni 8

Afati për dhënien e autorizimit

Siç është përcaktuar në Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare, Presidenti jep autorizimin, brenda afatit kohor prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune, nga data e pranimit të kërkesës nga Qeveria.

Neni 9
Nënshkrimi i Autorizimit

Autorizimi për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare, nënshkruhet nga Presidenti në kopjet origjinale të nevojshme.

Neni 10
Dërgimi i Autorizimit

1. Pas nënshkrimit të autorizimit nga Presidenti, Departamenti për Çështje Juridike e dërgon autorizimin Kuvendit, Qeverisë, respektivisht ministrisë ose agjencisë shtetërore përkatëse dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme.
2. Informatat për autorizimet nga Presidenti ruhen dhe administrohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme, siç është përcaktuar në Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 11
Regjistri për autorizimet e dhëna për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare

1. Departamenti për Çështje Juridike, mban Regjistrin për autorizimet e dhëna për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare.
2. Drejtori i Departamentit për Çështje Juridike cakton zyrtarin përkatës ligjor i cili do të jetë përgjegjës për mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të përcaktuar në paragrafin një (1) të këtij Neni.

KAPITULLI III – DHËNIA E AUTORIZIMIT NGA PRESIDENTI PËR KRYERJEN E VEPRIMEVE TË NDËRLIDHURA PËR LIDHJEN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE TË CILAT HYJNË NË FUQI NË DATËN E NËNSHKRIMIT

Neni 12
Kompetenca për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare, të cilat hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit

Kompetenca për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, të cilat hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit, autorizohen nga Presidenti pas rekomandimit të ministrisë ose agjencisë shtetërore, kompetencë e së cilës është hartimi i marrëveshjes ndërkombëtare,

Neni 13
Pëlqimi paraprak nga Ministria e Punëve të Jashtme

Rekomandimin, drejtuar Presidentit të Republikës së Kosovës, për dhënien e autorizimit për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, të cilat hyjnë në fuqi në datën e

nënshkrimit, bëhet pasi që Ministria e Punëve të Jashtme të këtë dhënë pëlqimin paraprak për marrëveshjen përkatëse.

Neni 14

Kërkesa për dhënien e autorizimit nga Presidenti

1. Kërkesa drejtuar Presidentit, për dhënien e autorizimit për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare, e cila hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit, ministria ose agjencia shtetërore i bashkëngjitet dokumentet në vijim:

- 1.1. Pëlqimi paraprak i Ministrisë së Punëve të Jashtme për marrëveshjen ndërkombëtare përkatëse dhe vendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për afatin kohor të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare;
- 1.2. Letrën shpjeguese të marrëveshjes ndërkombëtare që përfshin por nuk kufizohet në opinionet e dorëzuara nga ministritë ose agjencitë shtetërore gjatë periudhës së shqyrtimit;
- 1.3. Tekstin e projekt marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe, si dhe sipas nevojës, në gjuhën e huaj përkatëse.

Neni 15

Shqyrtimi i kërkesave

1. Kërkesa drejtuar Presidentit, për dhënien e autorizimit për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare, e cila hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit, shqyrtohet nga Departamenti për Çështje Juridike, gjegjësisht zyrtari përkatës ligjor i caktuar nga drejtori i departamentit.

2. Nëse kërkesa nuk është në pajtim me legjislacionin përkatës apo nuk është e kompletuar sipas legjislacionin përkatës, Departamenti për Çështje Juridike e kthen kërkesën tek propozuesi dhe kërkon plotësimin e kërkesës apo përmirësimin e saj dhe për këtë e njofton edhe Kabinetin e Presidentit.

3. Nëse kërkesa është në pajtim me legjislacionin në fuqi, Departamenti për Çështje Juridike përgatit propozim autorizimin sipas Shtojcës dy (2) (Autorizim për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare e cila hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit) të Rregullores dhe së bashku me Opinion Ligjor e dërgon për nënshkrim tek Presidenti.

Neni 16

Afati për dhënien e autorizimit

Siç është përcaktuar në Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare, Presidenti jep autorizimet, brenda afatit kohor prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune nga data e pranimit të kërkesës nga Qeveria, respektivisht ministria ose agjencia shtetërore përkatëse.

Neni 17
Nënshkrimi i Autorizimit

Autorizimi për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare, e cila hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit, nënshkruhet nga Presidenti në kopjet origjinale të nevojshme.

Neni 18
Dërgimi i Autorizimit

1. Pas nënshkrimit të autorizimit nga Presidenti, Departamenti për Çështje Juridike i dërgon autorizimin ministrisë ose agjencisë shtetërore përkatëse dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme.
2. Informatat për autorizimet nga Presidenti ruhen dhe administrohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme, siç është përcaktuar në Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 19
Regjistri për Autorizimet e dhëna për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare e cila hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit

1. Departamenti për Çështje Juridike, mban Regjistrin për autorizimet e dhëna nga Presidenti për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare e cila hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.
2. Drejtori i Departamentit për Çështje Juridike cakton zyrtarin përkatës ligjor i cili do të jetë përgjegjës për mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të përcaktuar në paragrafin një (1) të këtij Neni.

KAPITULLI IV - RATIFIKIMI I MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE NGA PRESIDENTI

Neni 20
Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Presidenti

Marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, përveç atyre që ratifikohen me ligj të votuar nga dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti.

Neni 21
Kërkesa për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare

1. Kërkesa për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare, të përcaktuara në nenin 20, dërgohet nga Ministria e Punëve të Jashtme tek Presidenti, duke i bashkëngjitur dokumentet si në vijim:
 - 1.1. teksti i marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe dhe sipas nevojës, në gjuhën e huaj përkatëse;
 - 1.2. Letrën shpjeguese të marrëveshjes ndërkombëtare, që përfshin por nuk kufizohet në opinionet e dorëzuara nga ministrinë ose agjencinë shtetërore gjatë periudhës së shqyrtimit;
 - 1.3. Projektin e dekretit të Presidentit për ratifikimit të marrëveshjes nga Presidenti, sipas formës të bashkëngjitur në Shtojcën tre (3) (Dekret për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare) të kësaj rregulloreje.

Neni 22
Shqyrtimi i kërkesave

1. Kërkesa, drejtuar Presidentit, për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare, shqyrtohet nga Departamenti për Çështje Juridike.
2. Nëse kërkesa nuk është në pajtim me legjislacionin përkatës apo nuk është e kompletuar sipas legjislacionin përkatës në fuqi, Departamenti për Çështje Juridike e kthen rekomandimin tek propozuesi dhe kërkon plotësimin e kërkesës apo përmirësimin e tij dhe për këtë e njofton edhe Kabinetin e Presidentit.
3. Departamenti për Çështje Juridike, pasi të shqyrton kërkesën përkatëse, nëse janë në pajtim me legjislacionin në fuqi, përgatit propozim dekretin për ratifikim të marrëveshjes ndërkombëtare dhe së bashku me Opinionin Ligjor e dërgon për nënshkrim tek Presidenti.

Neni 23
Regjistri për Dekretet e Presidentit për ratifikim të marrëveshjes ndërkombëtare

1. Departamenti për Çështje Juridike, mban Regjistrin për Dekretet e dhëna nga Presidenti për ratifikim të marrëveshjes ndërkombëtare.
2. Drejtori i Departamentit për Çështje Juridike cakton zyrtarin përkatës ligjor i cili do të jetë përgjegjës për mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të përcaktuar në paragrafin një (1) të këtij Neni.

KAPITULLI V- DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Publikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës

1. Dekretet për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe autorizimet e dhëna për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare dërgohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
2. Ministria e Punëve të Jashtme në pajtim me Nenin 20 (2) të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare dërgon një kopje të printuar dhe një elektronike të marrëveshjes ndërkombëtare në gjuhët shqipe dhe serbe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe kryen obligimet tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 25

Shtojcat

1. Pjesë e kësaj rregulloreje janë edhe Shtojcat si në vijim:
 - 1.1. Shtojca një (1) - Autorizim për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare;
 - 1.2. Shtojca dy (2) - Autorizim për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare e cila hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit, dhe
 - 1.3. Shtojca tre (3) - Dekret për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare.
2. Departamenti për Çështje Juridike, në rastet e veçanta dhe specifike përdor shtojcat e bashkangjitura duke ja përshtatur rastit dhe specifikeve të caktuara.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas nënshkrimit.

Hashim THAÇI,
President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, 07.10.2016

Shtojca 1- Autorizim për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

AUTORIZIM PËR KRYERJEN E VEPRIMEVE TË NDËRLIDHURA PËR LIDHJEN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Nr. ____/----

Presidenti i Republikës së Kosovës,
në mbështetje të nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 47, 25 janar 2009), dhe nenit 7 (paragrafët 1, 8 dhe 9) të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare (Gazeta Zyrtare nr. 28, 16 dhjetor 2011), si dhe duke marrë parasysh kërkesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës (Vendimi i Qeverisë Nr. xx/xx, --.--.----):

A U T O R I Z O N

XX Udhëheqës i Agjencisë shtetërore përkatëse, për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e Marrëveshjes ndërkombëtare (emërtimi i Marrëveshjes), në mes të XXXXX dhe XXXXX.

President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më --.----.---

Autorizimi t'i dërgohet:

- Kryetarit të Kuvendit të Kosovës;
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Ministrit të Ministrisë përkatëse apo Udhëheqësit të Agjencisë shtetërore përkatëse;
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- a/a

Shtojca 2 - Autorizim për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare e cila hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

AUTORIZIM PËR KRYERJEN E VEPRIMEVE TË NDËRLIDHURA PËR LIDHJEN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE E CILA HYN NË FUQI NË MOMENTIN E NËNSHKRIMIT

Nr. ____/----

Presidenti i Republikës së Kosovës,
në mbështetje të nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 47, 25 janar 2009), dhe nenit 7 (paragrafët 3, 7, 8 dhe 9) të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare (Gazeta Zyrtare nr. 28, 16 dhjetor 2011), si dhe duke marrë parasysh Pëlqimin paraprak të Ministrisë së Punëve të Jashtme për marrëveshjen ndërkombëtare përkatëse dhe Vendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për afatin kohor të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare(xx):

A U T O R I Z O N

XX Udhëheqës i Agjencisë shtetërore përkatëse, për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e Marrëveshjes ndërkombëtare (emërtimi i Marrëveshjes), në mes të XXXXX dhe XXXXX e cila hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më --.---.---

Autorizimi t'i dërgohet:

- Ministrit të Ministrisë përkatëse apo Udhëheqësit të Agjencisë shtetërore përkatëse;
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- a/a

Shtojca 3 - Dekret për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

DEKRET PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Nr. i Dekretit: DMN – 0XX (Numri i radhës) – Viti.

Presidenti i Republikës së Kosovës,
në mbështetje të nenit 18 dhe 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094, për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 47, 25 janar 2009), nenit 10 (4) të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare (Gazeta Zyrtare nr. 28, 16 dhjetor 2011), si dhe nenit 4 (3) të Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 26, 02 qershor 2008), si dhe duke marrë parasysh kërkesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar Presidentit, me datën ---.---.-----:

D E K R E T O N

Ratifikimin e Marrëveshjes XXXXX, e nënshkruar në mes të Republikës së Kosovës dhe XXXX, më XXXXX dhe e pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës më ---.---.-----.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më _____._____.20--

Dekreti t'i dërgohet:

- Kryetarit të Kuvendit të Kosovës;
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- a/a